

## Udhëzues për rihapjen graduale të objekteve publike fetare

Vjenë, me 10.05.2020

Në bazë të vendimit të BI të Austrisë (IGGÖ) për rihapjen e objekteve publike fetare me 15.05.2020 në përputhje me masat e rrepta të mbrojtjes së higjienës në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit për Çështje Fetare dhe bashkësitë tjera fetare, edhe Kuvendi i ALKIG-ut në takimin e tij me 10.05.2020 ka diskutuar mundësinë e rihapjes së xhamive brenda Komuniteti Shqiptar të BI të Austrisë ALKIG.

Duke pasur parasysh rregullat e rrepta siç janë: hapësira për një person gjatë faljes të jetë 10m<sup>2</sup>, distanca sociale 2 m, përdorimi i maskave, dezinfektimi i duarve, kontrolli i detyrueshëm në përmbajtjen e rregullave.

### Kuvendi i ALKIG-ut ka vendosur si në vijim:

1. Xhamitë shqiptare t'i përmbahen udhëzuesit të BI të Austrisë (IGGÖ) për rihapjen e objekteve fetare
2. Për shkak të ndryshueshmërisë së hapësirave, secila kryesi e xhamisë të vendosë nëse i plotëson kushtet për rihapje ose jo
3. Në rast të rihapjes së xhamive do të falet namazi i sabahut, drekës dhe ikindisë, kurse namazi i akshamit, jacisë-teravisë, xhumasë dhe namazi i bajramit nuk do të falen në xhami deri pas Ramazanit
4. Të mos zgjatet qëndrimi në xhami pas namazit
5. Xhamitë që nuk i plotësojnë kushtet të mos nxitohen në rihapjen e tyre deri në zbutjen e mëtutjeshme të masave parandaluese
6. Mbrojtja e jetës dhe e shëndetit është prioriteti kryesor në islam dhe kjo të merret në konsideratë edhe nga përgjegjësit e xhamisë
7. Kryesia bënë markimin e vendfaljes sipas rregullit 2m distanc
8. Kryesia mbanë përgjegjësi për shkeljen eventuale të masave mbrojtëse të cekura më lartë
9. Imami mbanë përgjegjësi për obligimet fetare dhe informon xhematin për masat mbrojtëse por nuk mbanë përgjegjësi për kontrollimin e zbatimit të masave mbrojtëse
10. ALKIG nuk mbanë përgjegjësi për veprimet që nuk përputhet me udhëzuesin e BI të Austrisë (IGGÖ)
11. Kryesia kujdeset për përdorimin apo mospërdorimin e lokalit për kohë të lirë dhe mbanë përgjegjësi për zbatimin e rregullave të parapara nga institucionet kompetente

12. Të merren parasysh edhe masat ndëshkimore për mos respektimin e rregullave të parapara nga institucionet kompetente lidhur me masat mbrojtëse
13. Kryesia kujdeset për vendosjen e plakatave informative rreth masave mbrojtëse
14. Kryesia kujdeset për mbajtjen jashtë funksionit të vendeve të abdestmarrjes dhe përdorimit të tualeteve. Pjesëmarrësit duhet të marrin abdest në shtëpi
15. Hapësirat e faljes të ajrosen para dhe pas faljes
16. Tepihët të pastrohen rregullisht
17. Kryesia siguron mjete dezinfektuese
18. Kryesia largon objektet e mundësisë së përdorimit të përbashkët (si xhybet, kapuçi, tespihet, sexhade, kur`ana, lugë të këpucëve)
19. Kutitë e sadakasë duhet të vendosen para ose pas hyrjes dhe nuk lejohet lëvizja e tyre tek çdo person
20. Kryesia kujdeset për listat e pjesëmarrësve, ruajtjen e të dhënave dhe asgjësimin e tyre pas katër javëve
21. Pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën 12 vjeçare, dhe personave me simptoma të sëmundjeve të ndryshme nuk lejohet
22. Pjesëmarrja e personave me rrezikshmëri mbi moshën 65 vjeçare nuk preferohet
23. Iftare të përbashkëta në xhami nuk lejohen
24. Kuvendi i ALKIG-ut preferon që rihapja e xhamive të filloj nga data 16.05.2020
25. Kryesia të informoi me kohë anëtarët e vetë për formën e funksionimit të xhamisë pas rihapjes

Këtij dokumenti i bashkangjiten edhe:

- Udhëzuesi i BI të Austrisë (IGGÖ)
- Pllakata informative e BI të Austrisë (IGGÖ) në shqip dhe gjermanisht

**Vahidin Beluli**

**Kryetar i Kryesisë së ALKIG**

**Emin Limani**

**Kryetar i Kuvendit të ALKIG**

